

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-086/14

Prishtinë, 13 Maj 2015

Në çështjen juridike të:

N.M.

Rruga Xhemajl Mustafa

Blloku V, hurja 5, Bodrum

Prishtinë

**Pala ankuese**

kundër

R.J.

Bosce, Kamenica/Kamenicë

Kosovo

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Willem Brouwer, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin 00149), pas shqyrtimit të mbajtur më 13 Maj 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e N.M. t, e paraqitur kundër Vendimit KPCC/D/C/224/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin 00149), të datës 27 nëntor 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 i datës 27 nëntor 2013 sa i përket lëndës KPA00149.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 25 korrik 2006, R.J. ka paraqitur një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) si përfaqësues i autorizuar i paraqitësit të kërkesës V.A. (më tej: pala përgjegjëse ne ankesë), duke kërkuar ri-posedimin e objektit afarist me hapësirë prej 50.15 m<sup>2</sup> në adresën Bela çeşma/Kroi i bardhe, nr.35 në Prishtinë. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA00149.
2. Pala përgjegjëse ne ankesë në AKP i ka dorëzuar dokumentet vijuese për ta mbështetur kërkesën e tij:
  - Autorizimin VR.nr.1221/2002 të dhënë nga pala përgjegjëse ne ankesë, e vërtetuar nga Gjykata Komunale e Kamenicës më 27 dhjetor 2002;
  - Procesverbalin e mbajtur gjatë takimit të mbajtur në Ndërmarrjen Publike Banesore më 15 korrik 1998 për dorëzimin e çelësave te objektit afarist;
  - Një certifikatë nr.02-1126/2 të datës 22 maj 1998 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore, që tregon se V.A. i ka plotësuar të gjitha obligimet ndaj Ndërmarrjes Publike Banesore;
  - Kontratën themelore nr.02/2827/1 të datës 22 nëntor 1996 mbi ndërtimin e objektit afarist dhe përvetësimin e pronës së kërkuar te lidhur ndërmjet Ndërmarrja Publike Banesore dhe V.A. ; Shtojcën e kontratës nr.02/1126/1 të datës 22 maj 1998; një certifikatë mbi shtetësinë nr. 04-204/315 të datës 17 shtator 1998, të lëshuar nga Komuna e Kamenicës.
3. Të gjitha dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht nga AKP.
4. Njoftimi fizik në pronën e kontestuar në lëndën KPA00149 fillimisht është bërë më 24 prill 2008. Raporti i njoftimit i kësaj datë lidhur me pronën e kërkuar tregon se prona ishte uzurpuar nga pala ankuese N.M. , i cili personalisht ka qenë i pranishëm gjatë procesit të njoftimit. Ai deklaroi se këtë pronë është duke e përdorur vetëm për qëllime të banimit dhe ai pretendon të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar. Ai gjithashtu deklaroi se ai nuk ka dashur të paraqes kërkesë në AKP. Është edhe një deklaratë në shkresat e

lëndës e nënshkruar nga pala ankuese N.M. më 21.05.2008 me të cilën ai pohon se pronën është duke e përdorur për qëllime të banimit, por ai nuk kërkon ndonjë të drejtë ligjore mbi të. Për me tepër ai nuk mori pjesë në procedurën e zhvilluar përpara KPKK-se.

5. Njoftimi i parë është bërë për pronën e gabuar, për këtë arsye AKP e ka informuar palën ankuese përsëri më 2 gusht 2010. Pas pranimit të njoftimit të AKP-së, më 06 gusht 2010 pala ankuese dorëzoi një deklaratë me të cilën deklaron se ai nuk pretendon ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar.
6. Në anën tjetër, pasi që njoftimi fillestar fizik i pronës së kërkuar është bërë gabimisht, më 24 mars është bërë ri-njoftimi i pronës. Gjatë njoftimit të dytë të pronës së kërkuar, ekipi njoftues gjeti se prona e kërkuar ishte një zyre e uzurpuar nga N.I., i cili po ashtu nuk e nënshkroi Njoftimin e Pjesëmarrjes.
7. Kërkesa mbeti e pakontestuar gjatë procedurës në shkallën e parë në kuptim që të dy personat që ishin duke i përdorur pronat në kohën e njoftimeve hoqën dorë nga e drejta e tyre për ta kontestuar kërkesën brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
8. KPKK aprovoi kërkesën me Vendimin KPPC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013.
9. Vendimi iu dorëzua N.M. t më 5 shkurt 2014. Më 10 shkurt 2014, ai paraqiti një ankesë kundër vendimit.

#### **Pretendimet e palës ankuese:**

10. Pala ankuese pohon se prona e kërkuar nuk është prona ku ai jeton. Ai deklaron se prona e kërkuar ndodhet rreth 50-60 m larg nga objektet ku ai jeton. Me ankesë ai i referohet vërtetimit jo të plotë të fakteve. Ai kërkon verifikimin e gjendjes faktike. Ai po ashtu thekson se më 8 gusht 2010, ai e ka informuar AKP-në rreth për këtë mospërputhje.

#### **Arsyetim ligjor:**

##### *Juridiksioni*

11. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.

##### *Pranueshmëria e ankesës*

12. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur nga një person i cili nuk ka qenë palë në procedurë në shkallën e parë para KPKK-së, i cili në mënyrë eksplicite ka vendosur që të mos marrë pjesë në procedurë.

13. Sipas nenit 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, një palë mund të paraqes një ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh që nga njoftimi i palëve nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës rreth vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

14. Neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh që pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive do ta njoftojë dhe dërgojë një kopje të kërkesës çdo personi përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i së njëjtës parasheh që *“çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe/ose çdo person i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive [...]”.*

15. Vetëm pala në procedurën e shkallës së parë ka të drejtën e paraqitjes së ankesës kundër Vendimit të KKKP-së. Sipas praktikës së Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme, i vetmi përjashtim ndaj këtij rregulli shfaqet nëse dhe kur personi i cili mund të kërkojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka pasur njohuri se kërkesa është paraqitur në AKP për shkak të njoftimit joadekuat dhe rrjedhimisht nuk është në gjendje të paraqes njoftimin e pjesëmarrjes gjatë zhvillimit të procedurës në shkallën e parë.

16. Në rastin konkret, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese ka qenë në dijeni për procedurën në lëndën nr.KPA00149 pasi që ai personalisht është njoftuar fillimisht më 24 prill 2008. Megjithatë, ai nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar, që është objekt i kërkesës në atë lëndë. Ai gjithashtu nuk ka paraqitur njoftimin e pjesëmarrjes sikurse kërkohet me nenin 10.2 të Ligji nr. 03/L-079. Gjykata Supreme vëren se njoftimi i dytë është bërë si duhet. Pala ankuese, gjatë njoftimit, shprehimisht ka deklaruar se ai nuk ka kërkuar ndonjë të drejta ligjore, interesa apo leje për shfrytëzimin apo uzurpimin e pronës së kërkuar. Pala ankuese përsëriti qëllimet e tija me deklaratën e datës 06 gusht 2010 me të cilën ai edhe një herë theksoi se ai nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar. Pasi që deklaroi se nuk ka kërkuar ndonjë interes ligjor mbi pronën e kërkuar, ai tani nuk ka legjitimitetin që të paraqes ankesë pranë Gjykatës Supreme kundër Vendimit të shkallës së parë.

17. Megjithatë, Gjykata Supreme e sheh të dobishme të theksoj së objekti i kërkesës në lëndën nr. KPA00149, e konkluduar me Vendimin nr. KPPC/D/C/224/2013, ka të bëjë me një hapësirë zyre me sipërfaqe prej 50.15 m<sup>2</sup> në adresën Kroi i Bardhe no.35 në Prishtinë, dhe jo objektet e banimit ku pala ankuese pretendon se është duke jetuar.

18. Pretendimet e palës ankuese si të tilla nuk janë objekt i këtij shqyrtimi. Ankesa e tij gabimisht e kundërshton vendimin e KKPK-së nr.KPPC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013. Pasi që ankesa nuk është e pranueshme, Gjykata Supreme nuk e ka detyrim të vendos mbi meritat e ankesës.

18. Ankesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme sipas nenit 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 nën-paragrafi (a) i Ligjit të Procedurës Kontestimore. Prandaj, Kolegji i Apelit të AKP-se ka vendosur sikurse në dispozitiv.

19. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të kërkuar të drejtën e tij të pretenduar pranë gjykatës kompetente nëse e konsideron të nevojshme.

### **Këshillë ligjore**

25. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetare e Kolegjit EULEX**

**Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it**

**Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it**